



## PROCESVERBAL II/2024

I mbajtur me rastin e mbledhjes së II (dytë) për vitin 2024 të Komitetit për Politikë dhe Financa të KK Suharekë

---

**Vendi:** KK Suharekë  
**Zyra:** Salla e Bordit të Drejtorëve  
**Data:** 20.02.2024  
**Ora :** 13:00

---

### **Prezentë:**

**Z. Bexhet Kuçi - Kryesues**  
*z. Urim Suka*  
*znj. Bulëza Kuçi*  
*znj. Sanie Kuçi Rexhepaj*  
*znj. Fidaije Kukaj*  
*z. Dardan Berisha*  
*z. Liridon Fandaj*

### **Të pranishëm tjerë:**

**Kryetari i Komunës z.Bali Muharremaj**  
Habibe Bytyqi - zyrtare për barazi gjinore  
Reshat Reshitaj - Zyrtar për informim  
Përfaqësues i OSBE-së  
Përfaqësues i LMT-së

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi Kryesuesi i Kuvendit z. Bexhet Kuçi i cili propozoi këtë:

### **Rend dite**

- 1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar;**
- 2. Shqyrtimi i projekt-vendimit për dhënien e pëlqimit për të zhvilluar procedurat përmes ankandit publik për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme të Komunës;**
- 3. Shqyrtimi i projekt-vendimit për miratimin e Planit Komunal të Veprimit për Eficiencën e Energjisë;**
- 4. Shqyrtimi i projekt-vendimit për miratimin e planit të Veprimit për Transparencë në Komunën e Suharekës;**
- 5. Shqyrtimi i Raportit vjetor për kontratat e nënshkruara publike në vitin 2023;**
- 6. Shqyrtimi i planifikimit përfundimtar të prokurimit për vitin 2024;**

**Kryesuesi** - gjithashtu kemi edhe dy kërkesa nga Kryetari.

**Kryetari** - përshëndet të pranishmit. Kërkesa e parë është rruga "Luigj Nikolla". E dini që është bërë shpronësimi para 4 viteve më duket. Kemi problem më tutje me një qytetar që është i Semetishtit që prona komunale po del një pjesë në oborr të tij dhe një pjesë është e jona. Ne kemi marrë vendim me ndërruar.

**Visar Kuçi** - është një pronë e cila është pjesë e komunës dhe është 219 m<sup>2</sup>. Në të njëjtën rrugë komuna me hartë zonale dhe me investimet që po i bën po e merr pronën private, është 268 m<sup>2</sup>, të njëjtën parcelë. Deri sa e kemi zgjidhjen, pala ka bërë kërkesë disa herë. Ne po e qojmë në Asamble për me bërë zgjidhje për ne si Komunë për këmbim të pronës.

**Armend Krasniqi** - kur është shtrur kjo rrugë në vitin 2018 për shkak të një pozicioni të keq kemi hyrë në teritorin e këtij që po e kërkon këmbimin. Kemi dy mënyra: ose me këmbim ose me na padit. Mendoj që këmbimi është zgjidhja më e mirë.

**Kryetari** - në mandatin e kaluar është bërë vlerësimi, komisioni ka caktuar çmimin dhe 10 ari janë pagu 60.000 euro nëse nuk gaboj. Edhe më tutje lëndën e kemi në gjykatë për arsye se pronari legjitim nuk është pajtu me atë çmim. Ajo rrugë ka qenë për me u krye 2016, 2017, 2018 dhe nuk është krye asnjëherë për arsye se nuk na ka lënë me krye. Materialin do ta keni me detale se ku është dhe çka është.

**Liridon Fandaj** - ne veç e kemi bërë një rrugë, që është shtrur pa shpronësim. Kryetari po thotë që nuk na ka lejuar. A është shtrur apo nuk është shtrur?

**Kryetari** - prona ka qenë në emër të Muhamet Elshanit. Ne atë që e kemi marrë, e kemi shpronësuar dhe e kemi paguar. Ka mbetur anash në dy anë.

**Liridon Fandaj** - nuk po e kuptoj. Nëse drejtori thotë që ai mundet me na padit që komuna nuk e ka shtrur në pjesë të rrugës, atëherë ai nuk ka të drejtë me na padit si komunë.

**Kryetari** - Kryetari tregon për 2 rastet e ngjashme konkrete.

**Armend Krasniqi** - kemi qindra raste prej viteve 68-ta ku nuk kanë ndodhur shpronësimet e tokave. Edhe rruga "Brigada 123" ka pjesë të pa shpronësuar kur është shtrur në vitet 68-ta. Drejtori tutje jep sqarime.

**Kryesuesi** - parcela çka merr poshtë rrugës "Luigj Nikolla" ka qenë pronë e Muhamet Elshanit dhe ai ia ka shit dikun një 10-15 familjeve dhe njëra prej atyre familjeve është kjo e Semetishtit.

**Urim Suka** - problematikat mund të jenë edhe të mëhershme si po thotë drejtori por nuk po e kuptoj shpejtësinë pse ka ardhë, pa mujt me e trajtu në më tepër. Investimi është krye. Unë mendoj që komuna nuk ka të drejtë me investu pa e bërë shpronësimin. Drejtori tha që ka qindra raste të tilla. Pse nuk po e bëni një

listë me rastet e evidentune dhe ta marrim një vendim nëse kemi të drejtë për krejt këto. Janë gjëra të paqarta për mua dhe nëse mundet dikush me sqaru më në detaje.

**Visar Kuçi** - jep sqarime.

**Urim Suka** - a ka qenë rrugë ekzistuese pa u shtrur rrugë e re?

**Visar Kuçi** - ka qenë rrugë ekzistuese e arave dhe tash është bërë zhvillimi.

**Urim Suka** - pse ka lind nevojë për me marrë atë pjesën private?

**Visar Kuçi** - sepse tash është investuar, kanë ardhë njerëzit me shtëpija dhe tash i ka hyrë vlera.

Drejtori tutje jep sqarime.

**Avni Bytyqi** - kërkesa e Kryetarit është që të inicohet procedura për shpalljen e interesit të përgjithshëm të pronës private. Kur të shpallet zonë me interes të përgjithshëm janë hapat konkret për vazhdimin e procedurës së mëturjes se çka deri në shpalljen e vendimit për këmbimin e pronës private me pronën publike. A lejohet me ligj kur pala bën kërkesë? Ligji e specifikon qartë se me kërkesën e palës këmbëhet prona vetëm në kufijtë kadastral ndërsa me kërkesën e komunës, prona publike me pronë private ndërrohet ku të don komuna mund ti jap propozim për arsye se është interesi i komunës më i madh se sa interesi i personit fizik.

**Sanie Kuçi Rexhepaj** - pjesa që kemi me marrë në si Komunë, a është me HZK e planifikuar si rrugë dhe pjesa që ka me marrë pala, a është e planifikuar për ndërtim apo rrugë?

**Visar Kuçi** - pjesën që komuna e merr është rrugë e planifikuar ndërsa pjesën që pronari e merr është bllok ndërtimi në kufij me rrugën.

**Kryesuesi** - e hedh në votim pikën shtesë që të futet në rend dite.

## 5 për, 2 abstenime, Miratohet

**Kryetari** - kërkesa tjetër është te një objekti që po ndërtohet te lagjja e Berishë-ve dhe aty ceket se sa marrim dhe sa japim.

**Visar Kuçi** - edhe këtu te pjesa mbrapa podrumit, sheshit, investitori ka bërë kërkesë. Tani më komuna që e ka shpronësuar një pjesë të kësaj pjese dhe ka hap një rrugë, tash me hartë zonale kur ka aplikua pala për bllokun tjetër, një pjesë është në pronë të komunës. Pjesa tjetër me hartë zonale janë disa pjesë që po prekin rrugë dhe është interesi i komunës që komuna me i marrë këto pjesë. Nëse tash nuk i merr këto pjesë, ky investitor ka me na nxjerr probleme për shkak se prona mbetet e tij dhe duhet me i zhvillu procedurat për shpronësim dhe në faktikisht jemi në bllok të ndërtimit. 120 m<sup>2</sup> i merr komunës dhe 144 m<sup>2</sup> i merr komuna pronarit.

**Urim Suka** - këmbimin a e bën zyra e ministrisë apo e bëni ju?

**Visar Kuçi** - jo, kjo është propozim.

**Kryetari** - shumë rrugë janë të parapara që kemi me pas probleme edhe në teren me harta zonale. Harta zonale e parasheh rrugën dhe dashte apo nuk dashte ti ke me shpronësu dhe ke me ja marrë. Kur ka mundësi me i dhënë vend afër, neve na konvenon përndryshe kur të fillohet me procedurat e vlerësimit atëherë kemi me pas probleme.

**Sanie Kuçi Rexhepaj** - ku po merret dhe ku po jepet?

**Kryesuesi** - është mbrapa shtëpisë së mallrave që ka qenë përpara ose ish Benaf, aty është objekti.

**Visar Kuçi** - harta zonale nuk është një dokument që është në detal. Drejtorja e Urbanizimit e ka të drejtën me bërë zgjerimin e kësaj rruge. Nëse unë e bëj zgjerimin, i bëj zgjidhje investitorit por neve po na mbesin këto prona pa i këmbë dhe në të ardhmen do të kemi telashe. Pala nuk ka me shfrytëzu këtë pjesë për ndërtim por do të mbes parking.

**Liridon Fandaj** - pjesa e konpenzimit nuk shkon sikur dje që ka qenë ara dhe si sot që ka infrastrukturë dhe në këtë rast dëmtohet prap komuna sepse ai nuk e pranon dhe ekspertin ndryshe e vlerëson një arë bujqësore dhe ndrysh e vlerëson me gjithë infrastrukturën. Mos po i japim në më shumë atyre personave fizik që me kërkua më shumë për shkak të infrastrukturës dhe ndryshimit.

**Kryetari** - ligji që është për ndërtim thotë :shpalle tenderin dhe në paramasë fute dhe shpronësimin. Nëse ne fillojmë në muajin mars me procedura dhe ti pret një vit për një lëndë që komisioni qeveritar me ta shpronësu, ne asnjë punë s'mund ta kryejmë asnjëherë. Me fillu si duhet me letra, ne asnjë punë s'mund ta kryejmë brenda viti sepse nuk varet prej nesh shpronësimi por prej një komisioni qeveritar.

**Liridon Fandaj** - rrugën deri në Dubravë e ke rregullu shumë mirë. Ajo është dasht të shpronësohet me 500€ dhe ti ja ke ngrit vlerën 2000€. Sot 2000€ ai kërkon shpronësim. Atyre iu ka konveno me u lëshu rruga. Atëherë merre një pëlqim që mos të dëmtohet nesër Komuna.

**Avni Bytyqi** - nuk kryhet puna me pëlqime.

**Urim Suka** - krejt kjo zhurmë që po bëhet për me hy në rend dite është vetëm për faktin që na ka ardhë drejtpërdrejtë dhe nuk kemi idenë se çka po flasim për momentin, vetëm ato që na thoni ju. Me pas dokumente si pikat tjera edhe ne ndoshta më lehtë e kishim kalu. Mundësisht mos me na ardhë kështu pikat sepse nuk po e kemi të qartë pastaj për me vendos. Me vendimet tona ne po e dëmtojmë komunën. Është mirë të fillohet me shpronësimet e pastaj me bo investime.

**Kryetari** - Kryetari tutje jep sqarime rreth kësaj pike.

**Kryesuesi** - e hedh në votim pikën e dytë shtesë.

**5 për,2 abstenime,Miratohet**

**Kryesuesi** - e hedh në votim rendin e ditës me dy pikat shtesë.

**5 për,2 abstenime,Miratohet**

### **Pika 1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar;**

**Kryesuesi** - a ka vërejtje në procesverbal?

**Urim Suka** - është një gabim te pika e 5 në fund ku unë them:prej 90 treguesve,13 i numërova që kanë dal më lart se 10.Unë nuk kam thënë 90 tregues por prej 19 fushave.

**Kryesuesi** - e hedh në votim pikën 1.

**Unanimisht Miratohet**

### **Pika 2.Shqyrtimi i projekt-vendimit për dhënien e pëlqimit për të zhvilluar procedurat përmes ankandit publik për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme të Komunës;**

**Kryesuesi** - e elaboron këtë pikë dhe hap debatin.

**Dardan Berisha** - në bazë të projekt-vendimit dhe kërkesës nga Drejtoria e Shërbimeve Pronësore Juridike më duket që është një gabim sepse te kërkesa nga DSHPJ thuhet për periudhën 10 vite dhe arsyetimi është shëndërimi i tokës vjerrinë në tokë punuese.

**Armend Krasniqi** - është një gabim teknik.

**Urim Suka** - unë e pata shqetësimin e njëjtë si të Dardanit. Është një lloj papërgjegjësie sepse këto janë dokumente publike. Te dhënia e pëlqimit është 1 deri 15 vite. Pse u bë për 10 vite?

**Kryesuesi** - në Asamble e vendosim sa e japim.

**Armend Krasniqi** - Urim përveq kritikës duhet me përmend edhe qëllimin e mirë që e ka një drejtori.

Këto lokale prej 2017-tës nuk kanë qenë në funksion. Tani kanë hy në funksion,janë regjistru, janë bërë ndarjet,kanë marrë procedurë për me votu në Asamble dhe Asambleja voton tutje dhe komuna përfiton.

**Urim Suka** - unë jam duke bisedu për vendimin që e ke sjell. Për sukseset që ti po thua,unë të përgëzoj por ti paguhesh për me i bo këto punë.

**Liridon Fandaj** - drejtori e tha sepse unë desha ta përgëzoj drejtorin për certifikatën e lokaleve. Deri tash kush i ka pas ato lokale?A është marrë naj masë ndaj tyre apo prapë ke me vazhdua me avazin që me marrë dikush dhe mos me pagu?

**Armend Krasniqi** - që nga 2017-ta komuna e Suharekës asnjë të hyrë nga ato lokale,me konstatimin që ato lokale janë të komunës por nuk e kemi ditë saktësisht të kujt janë dhe çka janë, Komuna ka dal në teren dhe e ka verifiku që lokalet janë të komunës. Drejtori tutje jep sqarime.

**Liridon Fandaj** - deri në 2017-tën a ka pas kontratë dikush?

**Armen Krasniqi** - deri në 2017-tën ka pas kontratë në mes disa operatorëve ekonomikë dhe komunës mirëpo kanë qenë kontratat fiktive që nuk është dasht me u bo ligjërshet sepse nuk ka pas certifikatë të pronës.

**Kryesuesi**- e hedh në votim pikën 2.

## Unanimisht Miratohet

### Pika 3. Shqyrtimi i projekt-vendimit për miratimin e Planit Komunal të Veprimit për Efiçencën e Energjisë;

**Kryesuesi** - elaboron pikën dhe thotë që për ndonjë pyetje apo sqarim të pranishëm janë edhe ekspertat e asaj lomie të cilët kanë marrë pjesë.

**Agim Bylykbashi** - komuna e Suharekës nga viti 2022 ka pas një marrëveshje me bashkëpronarët e programit ndërkombëtar dhe komuna ka përfitu një donacion nga ky program për efiçencë. Kompania e ka bërë planin e veprimit për efiçencë të energjisë elektrike dhe nëse drejtori kemi bërë prap kërkesë në agjensionin për energji dhe efiçencë në Prishtinë ku kemi kërku se a është në përputhshmëri me planin qëndror dhe përgjigja është kthyer pozitive.

**Naser Sahiti** - në cilësi të ekspertit kemi punu në realizim të planit komunal për efiçencë të energjisë ashtu si e parasheh edhe ligji. Ky plan ka kuptimin me i adresu të gjithë sektorët që janë konsumues të energjisë të cilat menaxhohen nga komuna për ta kursyer energjinë sepse ai reflektohet jo vetëm në kursim financiar por në të mira tjera. Janë adresu të gjitha sektorët relevant të komunës, kryesor është sektori i ndërtimit sepse është konsumuesi më i madh i energjisë. Nëse kalon plani komunal, një prej rekomandimeve është që të provoni që planin e zbatimit që është dhënë të futni në buxhete vjetore kur ti aprovonit dhe ti realizoni sa më shumë.

**Urim Suka** - në kuadër të planit që i keni parapa këto objekte të shkollave, a i keni parapa mundësitë e komunës dhe plani a lidhet me mundësitë buxhetore që i ka komuna apo jo?

**Avni Sfishta** - ne nuk kemi pas vlerë monetare në kuptimin sa është kapaciteti financiar i komunës për këto tri vite që ne me parapa. Mirëpo ne tu e marrë trendin e investimeve dhe kërkesave jemi mundu me qenë sa më real në kuptimin që plani me mujt me u realizu por prap është çështje e komunës deri në çfarë niveli mundet me investu. Avni Sfishta tutje jep sqarime.

**Naser Sahiti** - ne kemi dhënë disa ide se çfarë fushe me investu. P.sh renovimi i një pjese të stokut të ndërtesave, kryesisht publike. Qëllimi ka qenë që me mrri rreth 1-1.2 -% të kursimit të energjisë çdo vit pastaj për tre vite me ardhë në total rreth 3.24-5% të energjisë.

**Urim Suka** - gjatë hartimit të planit, a keni komunikuar me komunën dhe me barazu planin që po e hartoni me mundësitë reale që komuna i ka? E them këtë sepse ne po hartojmë shpesh plane dhe po mbesin vetëm si dokumente dhe nuk po gjejnë asnjëherë zbatim në teren.

**Avni Bytyqi** - normal që kanë qenë të inkuorporun ekzekutivi mirëpo përparësia e këtij plani është për arsye se në bazë të ligjit për efiçencën e energjisë ne kemi qenë të obliguar që paraprakisht ky plan i veprimit të miratohet edhe në Ministri që a është në harmoni dhe përputhshmëri me strategjinë e energjisë RKS-së dhe me programin e investimeve strategjike të energjisë. Për këtë plan ministria na ka konfirmu që plani komunal për efiçencë të energjisë i Komunës së Suharekës është në harmoni me planet që unë përmenda dhe mund të vazhdoni më tutje në Kuvend për miratim.

**Avni Sfishta** - neser nëse aprovohet plani dhe nëse aplikoni në fond të Kosovës për efiçencë për energji, nëse masa nuk është listume në plan, ata nuk e financojnë. Do të thotë edhe në kuptimin e financimit kemi listu dhe burimet tjera financiare të cilat kanë potencial për me investu.

**Naser Sahiti** - ne kemi pas takim këtu me drejtorët komunal, kanë qenë kto shifra, i kemi diskutu dhe zyrtarët komunal e kanë pas planin dhe e kanë shqyrtu dhe ku ka pas ndonjë koment apo vërejtje ne e kemi adresuar.

**Kryetari** - ne e kemi bërë një projekt në fshatin Vraniq. Me 1 shtator deri në fund të shtatorit, diku kemi pagu rrymë vetëm në Vraniq 100€ më pak. Nëse ne i marrim 20 fshatra si Vraniqi, ato dikun janë 2000€ në muaj dhe në vit rreth 24.000€. Tash do të startojmë nëpër shkolla.

**Kryesuesi** - e hedh në votim pikën 3.

**Unanimisht Miratohet**

**Pika 4. Shqyrtimi i projekt-vendimit për miratimin e planit të Veprimit për Transparencë në Komunën e Suharekës;**

**Kryesuesi** - e elaboron këtë pikë dhe hap debatin.

**Urim Suka** - kur jemi te transparenca,unë nuk mendoj që transparenca nënkupton me pas veq një plan por është vullneti i pushtetit që atë transparenca me qu dej n'fund. Dje e kam marrë një mesazh ku një grup qytetarësh kanë bërë një kërkesë në Drejtorinë e Urbanizmit dhe nuk kanë marrë përgjigje edhe pse ka kaluar afati një muaj.

**Sanie Kuçi Rexhepaj** - varet çfarë kërkesë është sepse urbanizmi ka disa afate.

**Urim Suka** -ata kanë kërku një sqarim.

**Avni Bytyqi** - nëse bën kërkesë për çasje në dokumente publike,afati është 7 ditë. Nëse bën kërkesë me kthi një përgjigje për një çështje të caktuar, ka mundësi deri në 45 ditë por nëse kërkohen prova shtesë për shkak të lëndës,ligji e jep mundësinë edhe 45 ditë tjera shtesë.

**Urim Suka** - kuptoj por ata s'kan marrë përgjigje fare.Kemi raste kur ne në Asamble kemi kërku me formu një komision që të shikoj se si janë implementu investimet kapitale dhe ju e keni qu dorën kundër. A është transparenca ky dokumenti që po e miratojmë ne apo ai që ju nuk lejoni qasje askund me pa ne se çka po ndodh me investimet dhe ku po shkojnë.Kryetar ,kjo po i bie që ti e pengon transparencën me u zbardh e vërteta e asaj çka ka ndodh.

**Kryesuesi** - çdo kërkesë që e keni pas,keni pas qasje.

**Urim Suka** - këtu shkruan që pas përfundimit të mbledhjeve të kuvendit dhe të komiteteve,zyra për informim është përgjegjës që të përgatis dhe të publikoj në faqen e Komunës dhe t'u dërgoj mediave informatat zyrtare mes pasqyrimin e ballafaqimit të opozitës dhe pozitës.A më tregoni vetëm një postim te komuna e Suharekës ku është dhënë një mendim i opozitës?

**Dardan Berisha** - asamblea live dëgjohet dhe ajo është transparente ndërsa te pika 5 dhe 6 pajtohem edhe unë me ty.

**Kryetari** - ne nuk jemi të përkryer dhe gjatë rrugës mund të bëjmë gabime por si Komunë kemi marrë 1.036.000€.

**Liridon Fandaj** - te ajo që po e thotë Urimi,ne vim në komision por del vetëm një foto dhe thuhet që u votuan të gjitha pikat e rendit të ditës.Kjo nuk është transparente sepse dikush është kundër.

**Kryesuesi** - e hedh në votim pikën 4.

**4 për, 3 apstenime,Miratohet**

**Pika 5. Shqyrtimi i Raportit vjetor për kontratat e nënshkruara publike në vitin 2023;**

**Kryesuesi** - hap debatin për këtë pikë.

**Urim Suka** - te ndërtimi i rrugës Peqan i Vogël dhe Semetisht janë parapa 430.000€, kontrata u bë 135.000 dhe shpenzimi është bërë 31.000. A është gabim?Janë edhe disa tjera. Në raportin e shpenzimeve që e kemi diskutu para një muaji,aty shkruan tjetër gjë që janë hargju paratë dhe këtu tjetër gjë.

**Fatos Kuçi** - sa i parket punës së pagesave te ZKF-ja unë nuk jam pjesë e asaj për të dhënë ty informata sqaruese më shumë. Unë mund të jap informata vetëm rreth kontratave të nënshkruara përmes zyrës së prokurimit. Paraprakisht listën e nënshkrimeve të kontratave të cilat janë se sa është vlera,kjo është vetëm për neve dhe për publikun të cilat i publikojmë në faqe të komunës.

**Urim Suka** - nëse këto çështje janë gabime teknike,rregulloji. P.sh. ndërtimi rrugës Samadraxhë-Studenqan 295.000 ka qenë planifikimi,kontrata është bërë 177.000 dhe investimi 90.000.Nëse kjo është në rregull,ku kanë shku paratë?

**Kryetari** - ti ke të drejtë me kërkim qasje mirëpo rruga s'ka përfunduar për arsye se ka qenë kontratë dy vjeçare dhe shtesa e asfaltit nuk është vendosur.

**Urim Suka** - nuk po e lidhi vetëm me këtë rrugë por është edhe te kanalizimi. Në raportin që e keni dërguar para një muaji aty shkruan 200.000 shpenzimi për kanalizim ndërsa këtu po figuron që s'është shpenzu.

**Kryetari** - ke me pas probleme te rruga Samadraxhë-Tërrnje dhe Sudenqan pastaj rruga Semetisht që kemi has problem me pronën. Ka qenë e paraparë 140.000, dalin punë shtesë me zyre të prokurimit 60.000.

Kemi punë kornizën në qershor dhe e parashohim një rrugë me 200.000€ por kur e shpallim hyn me 120.000.

**Kryesuesi** - e hedh në votim pikën 5.

**5 për, 1 kundër**  
**Miratohet pika 5**

#### **Pika 6. Shqyrtimi i planifikimit përfundimtar të prokurimit për vitin 2024;**

**Kryesuesi** - hap debatin.

**Liridon Fandaj** - në bazë të planit të prokurimit e kam pa një ndryshim. Në kornizë buxhetore për Peqan janë planifikuar disa rrugë tjera kurse në prokurim krejt diçka tjetër. Rrugën Lulëkuqja e kemi heq atëherë sepse ka dal në tender një herë ajo rrugë dhe e kemi shtrur një rrugë te shkolla, e kemi lënë ashtu sepse s'ka pas emër. Në plan të prokurimit është prap rruga "Lulëkuqja".

**Kryetari** - kur ka kaluar buxheti janë shënuar rrugët që kanë kaluar me vërejtje. E kemi bërë një gabim në Gjinoc që ka qenë rruga "Jahir Zeqiraj" ndërsa ne e kemi bërë "Tahir Zeqiraj" por e kemi ndryshuar. Në Panamasë figurojnë të gjitha.

**Urim Suka** - shqetësimi është që u miratu me një emër ndërsa në plan të prokurimit del me emër tjetër.

**Kryetari** - kur të shpallet tenderi kodi nuk mundet me ndryshuar.

**Liridon Fandaj** - e kam biseduar me zyrtarin e financave, ai është përshkrim në eksell dhe kodi nuk ndryshon por emri ndryshon. Rrugë "Lulëkuqja" po del 4 herë në tender, vetëm përshkrimin ndryshoj.

**Kryetari** - ashtu si thua ti, ashtu del por kodi nuk ndryshon por në paramasë vendoset emri, sa metra katror ndryshon kur të shpallet tenderi. Kryetari tutje jep sqarime edhe rreth emërimit të rrugëve.

**Kryesuesi** - e hedh në votim pikën 6.

**5 për, Miratohet pika 6**

#### **Pika 7. Shpallja e inversit të përgjithshëm;**

**Kryesuesi** - e hap debatin. Pasi nuk ka debat Kryesuesi e hedhë në votim pikën 7.

**4 për, 1 abstenim**  
**Miratohet pika 7**

#### **Pika 8. Shpallja e interesit të përgjithshëm;**

**Kryesuesi** - e hap debatin. Pasi nuk ka debat Kryesuesi e hedhë në votim pikën 8.

**4 për, 1 abstenim**  
**Miratohet pika 8**

**Takimi përfundoi: 14:50**

**Procesmbajtësja:**  
**Dafina Haziraj**

